

Titulli i lëndës: Kritikë intermediale

Informatat themelore për lëndën	
Njësia akademike:	Fakulteti i Filologjisë, Departamenti: Gjuhë dhe Letërsi Gjermane
Titulli i lëndës:	Kritikë intermediale
Niveli:	MA
Statusi i lëndës:	Zgjedhore
Viti i studimeve:	Viti i V (semestri X)
Numri i orëve në javë:	2+1
Kreditë ECTS:	4 ECTS
Koha / Vendi:	Sipas orarit
Mësimdhënësi:	Prof. asoc. Dr. Albulena Blakaj- Gashi
Të dhënat kontaktuese:	Tel: 038222970/ albulena.blakaj@uni-pr.edu
Përshkrimi i lëndës:	<p>Lënda zgjedhore <i>Kritikë intermediale</i> ka për qëllim njoftimin e studentëve me kërkimet komparatistike që nisen nga letërsia dhe dalin në fusha të tjera të artit. Sot studimet interdisiplinare janë në qendër të interesimit. Interdisiplinariteti nënkupton domene të ndryshme të shkrimit, kurse intermedialiteti i referohet krahasimit mes tekstit letrar dhe mediumit teatral, filmik, të arteve pamore etj.</p> <p>Intermedialiteti nuk është fenomen i ri, marrëdhëniet intermediale kanë ekzistuar qysh nga antikiteti, megjithatë studimet për intermedialitetin si koncept akademik datojnë nga vitet e 1960-ta. Tekstet letrare gjithmonë kanë pasur marrëdhënie të ngushta me muzikën dhe imazhet, si shembull këtu mund të marrim emblemën dhe poezinë.</p> <p>Edhe relacioni i letërsisë me filmin ka më shumë se një shekull traditë. Si çdo art i ri, edhe filmi merr nga artet e vjetra, sidomos nga letërsia dhe piktura. Madje filmi edhe quhet pikturë lëvizëse (<i>motion picture</i>). Duke inkadruar letërsinë dhe pikturën brenda vetes, filmi</p>

bëhet një *pikturë që flet*. Pasi që, skenari është baza e filmit, mund të thuhet se filmi ka për bazë letërsinë, derisa skenari është plani letrar i filmit. Prandaj, lidhjet mes letërsisë dhe mediemeve tjera artistike do të jenë në qendër të studimit të këtij kursi.

Qëllimet e lëndës:

Qëllimet e kësaj lënde janë:

- t'i njoftojë e t'i avancojë njohuritë e studentëve me studimet interdisiplinare dhe intermediale,
- t'i njoftojë me kërkimet komparatistike që nisen nga letërsia dhe dalin në fusha të tjera të artit
- t'u ofrojë studentëve mundësi për të reflektuar për ndikimet e ndërsjella të letërsisë dhe arteve të tjera
- të avancojë njohuritë e studentëve për artet e tjera
- t'i aftësojë studentët në krahasimin mes tekstit letrar dhe mediemeve tjera (teatrit, filmit, arteve pamore, etj)

Rezultatet e pritshme të nxënies:

Pas përfundimit të kësaj lënde studentët do të:

- dijnë për trendet e studimeve interdisiplinare
- dijnë për intermedialitetin si krahasim mes tekstit letrar dhe medimeve tjera artistike;
- ndikimin e formave të ndryshme letrare në mediumin e teatrit e atë kinematografik;
- të analizojnë e të krahasojnë mes veprave letrare dhe krijimeve tjera artistike;
- të analizojnë dhe t'i prezantojnë gojarisht a me shkrim ngjajshmëritë dhe dallimet mes një filmi a një shfaqjeje teatrale dhe një vepre letrare mbi bazën e së cilës janë realizuar ato.

Ngarkesa e studentit (duhet të jetë në përputhje me rezultatet e nxënies së studentit)

Aktiviteti	Orë mësimore	Ditë/Javë	Gjithsej
Ligjëratat	2	15	22.5
Teori/Punë në laborator/Ushtime	1	15	11.25
Punë praktike			
Përgatitje për test intermediar	10	1	10
Konsultime me mësimdhënësin	10 min	15	2.5
Testi, punimi i seminarit	2	2	4
Detyrë shtëpie	1	15	15
Mësimi individual (në bibliotekë apo në shtëpi)	2	15	22,5
Përgatitja për provimin final	15	1	15
Koha e vlerësimit (testi, kuizi, provimi final)	2	1	2
Projektet, prezantimet, etj.	30 min	1	0.5
Total			105.25:25= 4.21 4 ECTS

Metodat e mësimdhënies:	Lënda përbëhet nga 2 orë ligjërata dhe 1 orë ushtrime në javë, ku do të jepet baza teorike dhe do të shihet se si funksionon intermedialiteti edhe në praktikë. Rrjedhimisht mësimi mbahet në formë interaktive. Vend do t'i jipet edhe prezantimeve të punimeve seminarike dhe diskutimeve për to. Studentët marrin pjesë në mënyrë aktive në klasë dhe zhvillojnë diskutime me kolegët.
Metodat e vlerësimit:	<ul style="list-style-type: none"> • Provimi përfundimtar 30% • Punimi seminarik 50% • Aktiviteti në klasë 20%
Literatura primare:	<p>- Doerr, Kurwinkel (Hrsg): Intertextualität, Intermedialität, Transmedialität: Zur Beziehung zwischen Literatur und anderen Medien, Königshausen u. Neumann, 2014</p> <p>- Rippl, Gabriele: Handbook of Intermediality, De Gruyter, 2015</p> <p>- Hutcheon, Linda (2006): A Theory of Adaptation, Taylor & Francis, New York.</p> <p>- Mahne, Nicole: Transmediale Erzähltheorie: Eine Einführung (Englisch) Taschenbuch – September 2007</p> <p>-Meier, Linda: Intermedialität - Wechselwirkungen zwischen Literatur und Film, Grin Verlag, 2013</p> <p>- Prette, M. C.: Kunst verstehen: Alles über Epochen, Stile, Bildsprache, Aufbau, Naumann & Göbel; Auflage: 3, 2009</p>
Literatura shtesë:	<p>- Stefan Volk: <i>Film lesen. Ein Modell zum Vergleich von Literaturverfilmungen mit ihren Vorlagen.</i> Tectum, Marburg 2010.</p> <p>Paech, Joachim: Literatur und Film, Metzler, J B; Auflage: 2., überarbeitete Auflage, 1997</p> <p>-Seymour Chatman, <i>Story and Discourse (Narrative Structure in Fiction and Film)</i>, Ithaca, NY: Cornell University Press, 1978.</p> <p>- Gebhardt, Volker: <i>Schnellkurs Kunstgeschichte Malerei</i>, DuMont Buchverlag; Auflage: 3, 2008</p>

Hartimi i planit mësimor	
Java	Titulli i ligjëratisë
Java 1:	Njohja me lëndën
Java 2:	Intermedialiteti, aspekti historik dhe kategoritë intermediale
Java 3:	Intermedialiteti dhe intertekstualiteti

Java 4:	Lidhjet intermediale mes tekstit dhe imazhit
Java 5:	Letërsia dhe piktura- ndikimet e ndërsjella
Java 6:	Filmi dhe artet pamore
Java 7:	Letërsia dhe filmi, kategoritë e adaptimit filmik
Java 8:	Rrëfimi intermedial (Intermediales erzählen - Berlin Alexanderplatz)
Java 9:	Estetika e dhunës, letërsia e luftës në film (Im Westen nichts neues)
Java 10:	Estetika e dhunës, letërsia e luftës në film (Der Vorleser)
Java 11:	Prezantimi i letërsisë përmes mediumeve tjera - Comic novels (Faust)
Java 12:	Letërsia dhe muzika
Java 13:	Poezia në muzikë
Java 14:	Prezantim i punimeve seminarike
Java 15:	Prezantim i punimeve seminarike

Politikat akademike dhe kodi i sjelljes

Studentët janë të obliguar t'i vijojnë ligjëratat dhe ushtrimet. Nuk tolerohen më shumë se tri mungesa gjatë semestrit. Detyrat që dalin nga këto orë mësimi janë të obligueshme dhe pjesë e vlerësimit të përgjithshëm të studentit. Plagjiatura dhe kopjimi në provime dhe punimet e tjera me shkrim janë të dënueshme. Në rastet e tilla studenti i nënshtrohet masave disiplinore, siç parashihet me rregulloret e UP-së.